



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS, (KGJK) në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 30, paragrafit 4 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 14 paragrafit 3 dhe 4 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat, si dhe nenit 30 të Rregullores mbi Organizmin dhe Veprimtarinë e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në mbledhjen e 214-të, të mbajtur me 21 shkurt 2019, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. Z. Artan Sejrani, caktohet nën kryetar në Gjykatën Themelore në Prizren.
- II. Mandati i z. Sejrani, si nën kryetar i gjykatës është i njëjtë me mandatin e kryetarit të gjykatës, ashtu siç është përcaktuar me nenin 14 paragrafit 3 të Ligjit Nr. 06/L-054 për Gjykatat.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 21 shkurt 2019.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me datë 19 shkurt 2019, ka pranuar një letër nga Kryetari i Gjykatës Themelore në Prizren z. Ymer Hoxha, përmes së cilës i propozon KGJK-së, që të caktoj gjyqtarin Artan Sejrani, nën kryetar të gjykatës.

KGJK në takimin e mbajtur me datë 21 shkurt 2019, pasi që shqyrtoi dhe analizoi me kujdes propozimin e Kryetarit z. Hoxha, caktoi z. Artan Sejrani, nën kryetar të gjykatës, i cili do të ndihmojë në menaxhimin e gjykatës dhe në mungesë të kryetarit të gjykatës shërben si ushtrues detyre i kryetarit të gjykatës. Andaj, bazuar në këtë u vendos në dispozitiv të këtij Vendimi.



Nëna IDRIZI,

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet:

- Z. Artan Sejrani, gjyqtar, Gjykata Themelore Prizren;
- Z. Ymer Hoxha, Kryetar i Gjykatës Themelore në Prizren;
- Sekretariatit të KGJK-së;
- Arkivit.